



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gillogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. **020/04-5294** dt. **31/10/2024**



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3, 4, 5, 6 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gillogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.10.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Për plotësim/ndryshimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit nr.02-020/04-14930 i dt.28.03.2023

Neni 1

Me këtë vendim plotësohet/ndryshohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit nr.02-020/04-14930 i dt.28.03.2023, në këtë përbërje:

1. Valentina Gashi Leku
2. Jahir Hajdari
3. Selman Qallapeku (Propozohet nga Grupi i Asambleistëve të VV-së)
4. Laurita Muhadri Bujupi
5. Egzon Qorri

Neni 2

Me këtë vendim obligohet komisioni që të bëjë shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve dhe pas shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe ankesave komisioni harton raportin dhe i propozon kuvendit listën për aprovim.

Neni 3

Me këtë vendim obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor që të bëjë regjistrimin për emërtim të rrugëve që merr vendim kuvendi për ndryshim apo emërtim të ndonjë rruge të re.

Neni 4

Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e mandatit të asamblistit.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani



Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

Arsyetim

Ky propozim vendim është bërë mbas dorëheqjes së anëtarit të komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit, të anëtarit të Grupit të Asambleistëve të VV-së, z.Drin Halilaj.

I tërë emërtimi dhe riemërtimi të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike që ndryshe quhen “Zona për Qarkullimin Publik” duhet të bazohet në Ligjin Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave dhe në aktet nënligjore të këtij ligji në cilat parashihen edhe ndryshimet të cilat ndodhin në hapësire, zhvillimet e reja urbane, rrugët e reja, rastet kur rrugët duhet ose mund të ri-emërtohen etj.